

20080881655

LIGJ
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
LIGJIT PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE INVALIDË

Neni 1

Në Ligjin për punësimin e personave invalidë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 44/2000, 16/2004, 62/2005, 113/2005 dhe 29/2007), në nenin 9 paragrafin 1 fjalët: "pesë persona" zëvendësohet me fjalët: "dhjetë persona", ndërsa fjalia e dytë bëhet paragraf 2.

Paragrafët 2 dhe 3 bëhen paragrafë 3 dhe 4.

Neni 2

Në nenin 11 paragrafi 2 ndryshon si vijon:

"Bashkësia nga paragrafi 1 i këtij neni bën mbikëqyrje në punën e shoqatave mbrojtëse, mban evidencën e personave të punësuar invalidë, shoqatave mbrojtëse dhe numrit dhe strukturës së të punësuarve në shoqatat mbrojtëse, ndërsa për parregullsitë e konstatuara nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me kushtet e veçanta për punësimin dhe punën e personit invalid, Bashkësia është obliguar ta informojë Inspektoratin shtetëror për punë."

Neni 3

Në nenin 15 paragrafi 1 përqindja "5%" zëvendësohet me përqindjen "10%".

Neni 4

Në nenin 16-a fjalia hyrëse e paragrafit 1 ndryshon si vijon:

"Në suazat e mjeteve në dispozicion nga Fondi i veçantë ndahen mjete të pakthyeshme për":

Pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 2, si vijon:

"Kriter themelor për përcaktimin e lartësisë së mjeteve të pakthyeshme të ndara për pajisje nga pika 3) e këtij neni është numri i personave invalidë të punësuar. Lartësia e mjeteve të cilat ndahen përcaktohet në mënyrën si vijon:

- deri në 20 rroga nëse numri i përgjithshëm i personave të punësuar invalidë te punëdhënësi është deri në 2;
- deri në 40 rroga nëse numri i përgjithshëm i personave të punësuar invalidë te punëdhënësi është prej 3 deri në 5;
- deri në 60 rroga nëse numri i përgjithshëm i personave të punësuar invalidë te punëdhënësi është prej 6 deri në 8;
- deri në 80 rroga nëse numri i përgjithshëm i personave të punësuar invalidë te punëdhënësi është prej 9 deri në 12;
- deri në 100 rroga nëse numri i përgjithshëm i personave të punësuar invalidë te punëdhënësi është prej 13 deri në 20;
- deri në 130 rroga nëse numri i përgjithshëm i personave të punësuar invalidë te punëdhënësi është prej 21 deri në 35;
- deri në 160 rroga nëse numri i përgjithshëm i personave të punësuar invalidë te punëdhënësi është prej 36 deri në 50; dhe
- deri në 200 rroga nëse numri i përgjithshëm i personave të punësuar invalidë te punëdhënësi është mbi 51".

Në paragrafin 2 i cili bëhet paragraf 3 në fund të fjalisë pika shlyhet dhe shtohen fjalët: "dhe nëse kërkuesi nuk e ka zvogëluar numrin e personave invalidë nga neni 9, paragrafi 1 i këtij ligji për punësimin e të cilëve janë shfrytëzuar mjete nga Fondi i veçantë."

Paragrafi 4 shlyhet.

Paragrafët 5, 6 dhe 7 bëhen paragrafë 4, 5 dhe 6.

Neni 5

Në nenin 16-b, paragrafi 6 pas fjalëve: "në fuqi të këtij ligji," shtohen fjalët: "ndërsa për punësimin e të cilëve janë shfrytëzuar mjete nga Fondi i veçantë,".

Pas paragrafit 7 shtohet paragraf i ri 8 si vijon:

"Shfrytëzuesi i mjeteve të cilit me aktvendim të Këshillit drejtues të Agjencisë i janë ndarë mjete nga Fondi i veçantë në bazë të të dhënave të pasakta për të cilat ka ditur ose detyrimisht është dashur ta dijë se janë të pasakta, respektivisht në mënyrë tjetër kundërligjore e ka realizuar të drejtën e mjeteve të ndara nga Fondi i veçantë, është i detyruar që në afat prej 60 ditësh t'i kthejë mjetet e pranuar dhe ta kompensojë dëmin eventual. Nëse shfrytëzuesi i mjeteve dhe Agjencia nuk merren vesh, Agjencia do t'i parashtrijë padi gjykatës kompetente për kthimin e mjeteve të pranuar pa bazë."

Neni 6

Në Kreun VI. fjalët: "DISPOZITA NDËSHKUESE" zëvendësohen me fjalët: "DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE".

Neni 7

Neni 20 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 1.800 deri në 2.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë mbrojtëse nëse nuk i plotëson kushtet nga neni 9 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 400 deri në 600 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personit përgjegjës të shoqëria mbrojtëse".

Neni 8

Neni 20-a ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 1.800 deri në 2.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse vepron në kundërshtim me nenin 4-a dhe nenin 16-b paragrafët 1 dhe 7 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 400 deri në 600 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personit përgjegjës të personi juridik".

Neni 9

Neni 21 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 1.800 deri në 2.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse nuk i plotëson kushtet nga neni 5 i këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 400 deri në 600 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personit përgjegjës të personi juridik".

Neni 10

Neni 22 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 1.800 deri në 2.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit nëse mjete e marra nga Fondi i veçantë nuk i shfrytëzon në pajtim me neni 16-a, paragrafi 5 i këtij ligji".

Neni 11

Neni 23 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 800 deri në 1.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit invalidë i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari nëse mjetet e marra nga Fondi i veçantë nuk i shfrytëzon në pajtim me neni 16-a, paragrafi 5 i këtij ligji".

Neni 12

Neni 24 ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 800 deri në 1.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të Agjencia nëse ndan mjete në kundërshtim me neni 16, paragrafët 2, 5 dhe 7 të këtij ligji".

Neni 13

Pas nenit 24 shtohet neni i ri 24-a, si vijon:

"Neni 24-a

Para parashtrimit të kërkesës për procedurë për kundërvajtje për kundërvajtjet e parapara në këtë ligj, Ministria mban procedurë për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje."

Neni 14

Në afat prej dy vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shoqëritë mbrojtëse ekzistuese janë të detyruara të harmonizohen me neni 9 paragrafin 1 të këtij ligji.

Shoqëritë mbrojtëse ekzistuese deri në skadimin e afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të shfrytëzojnë mjete të pakthyeshme nga Fondi i veçantë, nëse i plotësojnë kushtet e përcaktuara në neni 16-a të këtij ligji.

Nëse pas skadimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, shoqëritë mbrojtëse ekzistuese nuk harmonizohen me neni 9, paragrafi 1 të këtij ligji, pushojnë të punojnë si shoqëri mbrojtëse.

Neni 15

“Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.